

VENDIM
Nr. 470, datë 26.7.2018

PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRAVE
KULTURORE PËR DIASPORËN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 5 e 6, të nenit 6, të ligjit nr. 16/2018, “Për diasporën”, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të vendimit nr. 58, datë 31.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për qendrat kulturore në diasporë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e qendrave kulturore për diasporën (në vijim “QKD”), si persona juridikë, publikë, në varësi të kreut të misionit diplomatik të akredituar në vendin pritës.
2. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me ligjin nr. 16/2018, “Për diasporën”, dhe i raportojnë, mbikëqyren e koordinohen nga Agjencia Kombëtare për Diasporën (AKD).
3. QKD-të kanë si mision ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë.
4. QKD-të kryejnë këto funksione administrative:
 - a) Promovojnë Shqipërinë në ruajtjen, kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të diasporës dhe forcimin e lidhjeve të saj me institucionet e Republikës së Shqipërisë;
 - b) Nxisin dhe zhvillojnë njohuri për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore të Shqipërisë;
 - c) Nxisin bashkëpunimin shkencor, teknik, teknologjik, sportiv e ekonomik, artistik dhe kulturor, ndërmjet Shqipërisë dhe diasporës;
 - ç) Mbështesin dhe organizojnë rininë dhe grup-moshat e ndryshme të diasporës me aktivitete kulturore, edukative, sportive etj.;
 - d) Bashkëpunojnë me institucione të tjera për të zhvilluar aktivitetin e tyre brenda dhe jashtë vendit;
 - dh) Kryejnë detyra të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
5. QKD-të e ushtrojnë veprimtarinë në vendet me interes për diasporën, me qëllim mbartjen e trashëgimisë kulturore, të identitetit etj. dhe hapen me marrëveshje dypalëshe me shtetet e këtyre vendeve.
6. Struktura dhe organika e QKD-së miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për diasporën.
7. QKD-të financohen nga buxheti i miratuar për përfaqësinë diplomatike.
8. Misionet diplomatike ku do të ushtrojnë aktivitetin e tyre QKD-të, funksionet që do të kryejnë, raportet me kreun e misionit, si edhe çështje të tjera të veprimtarisë së tyre rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për diasporën.
9. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të QKD-së miratohet me urdhër të kreut të misionit diplomatik, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për punët e jashtme dhe të ministrit përgjegjës për diasporën.
10. QKD-ja drejtohet nga titullari, i cili administron dhe drejton veprimtarinë e përditshme të saj dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët. Për veprimtarinë e tij administrative ai përgjigjet para kreut të misionit diplomatik dhe ministrit përgjegjës për diasporën. Për çështjet që kërkojnë vendimarrje politike, titullari i QKD-së duhet të marrë mendimin e kreut të misionit.
11. Titullari i QKD-së emërohet dhe lirohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën, në përputhje me pikën 2, të nenit 31, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”.

12. Titullari ushtron të gjitha kompetencat për drejtimin e veprimtarisë së institucionit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me funksionet e objektivat e QKD-së, si më poshtë:

- a) Drejton dhe përfaqëson QKD-në;
- b) I raporton kreut të misionit diplomatik, ministrit përgjegjës për diasporën dhe drejtorit ekzekutiv të AKD-së;
- c) Bashkërendon punën ndërmjet strukturave të qendrës dhe cakton detyra dhe objektiva përkatës për t'u realizuar nga këto struktura;
- ç) Propozon programin vjetor të veprimtarive të QKD-së, të cilin ia paraqet për miratim kreut të misionit diplomatik dhe për dijeni ministrit përgjegjës për diasporën e drejtorit ekzekutiv të AKD-së;
- d) Kontrollon mbarëvajtjen e aktivitetit të QKD-ve, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar dhe realizimin sa më të plotë të funksioneve të saj, si dhe merr masat e nevojshme për koordinimin sa më mirë të punës ndërmjet strukturave të QKD-së;
- dh) Informon rregullisht dhe përgjigjet te kreu i misionit diplomatik, ministri përgjegjës për diasporën dhe drejtori ekzekutiv i AKD-së për mbarëvajtjen e aktivitetit të QKD-së dhe për realizimin e funksioneve të saj.

13. Titullarët e QKD-ve, të emëruar në misionet diplomatike, pajisen me pasaportë diplomatike dhe gëzojnë të njëjtin status me diplomatët gjatë periudhës që janë të emëruar në këto misione. Ata marrin gradë diplomatike, në varësi të strukturës së misionit diplomatik, dhe trajtohen financiarisht me pagën, shtesat mbi pagë dhe kompensimin për koston e jetesës sipas gradës së emërimit në misionin diplomatik në vendin ku shërbejnë.

14. Anëtarët e familjes së titullarëve pajisen me pasaporta diplomatike dhe gëzojnë të njëjtin trajtim me familjet e anëtarëve të diplomatëve, sipas ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm, të Republikës së Shqipërisë", dhe të akteve nënligjore në fuqi.

15. Nëpunësit e QKD-ve do të punojnë me kohë të plotë, por nuk do të jenë të akredituar në shtetin pritës. Ata emërohen nga ministri përgjegjës për diasporën, me propozim të kreut të misionit diplomatik.

16. Vulat e QKD-ve kanë formën dhe elementet sipas përcaktimit të vendimit nr. 390, datë 6.8.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e prodhimit, administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare".

17. Stema e QKD-ve përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet "Republika e Shqipërisë", "Ambasada përkatëse", "Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme", si dhe "Qendra Kulturore për Diasporën", në përputhje me vendimin nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e përdorimit të stemës së republikës dhe raportin e përmasave të saj", të ndryshuar.

18. Ngarkohen ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, ministri i Shtetit për Diasporën, Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Qendrat Kulturore për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama